



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPSTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Komuna e Klinës

Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

06-06-17083/23
Klinë, data: 22.05.2023

Për: Qytetarët e Komunës së Klinës

Lokacioni: Ndërtesa e Kuvendit Komunal Klinë

Data: 29.05.2023

Koha: 14:00

FTESË PUBLIKE PËR PJESËMARRJE NË DISKUTIM TË HAPUR PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË KLINËS 2023-2031

Të nderuar qytetarë të Komunës së Klinës,

Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit (DUMM) në bashkëpunim me O.Sh. "UBT" nga Prishtina, ka kënaqësinë t'ju ftojë në diskutimin publik lidhur me sfidat, problemet dhe kufizimet që hasni në dokumentet ekzistuese të planifikimit. Gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Klinës 2023-2031, bashkëpunimi ynë mund bëjë ndryshimet dhe plotësimet e duhura, si dhe të avancojë komunën tonë.

DUMM kërkon pjesëmarrjen tuaj aktive dhe të zëshme, që të jeni të informuar mbi përpjekjet e Komunës për të përgatitur Planin Zhvillimor Komunal të Klinës 2023-2031. Pjesëmarrja juaj do të mundësojë një planifikim të mirëfilltë duke paraqitur propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja për të kontribuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë në përmirësimin e jetës të secilit qytetar të komunës sonë.

DUMM është e përkushtuar të bashkëpunojë ngushtë me të gjitha palët e interesuara për përgatitjen e një Plani Zhvillimor Komunal të qëndrueshëm për komunën tonë dhe pronat tuaja.



Drejtori i DUMM-it,
Enver Berisha,